



Npi – 01/211 datë: 29.09.2020

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020 të z.Sali Beqa - Petrovë, si dhe kërkesën e banorëve të fshatit Davidovc të cilët nga Kuvendi i Komunës së Shtimes kanë kërkuar që të gjejnë një zgjidhje për pronën e Sali Beqaj në Davidovc me Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, me sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, i cili ka thënë se nuk po mundet, ta shfrytëzojë për shkak të pengesave nga banorët e fshatit Davidovc. Nga Kuvendi po kërkojmë të na bëj një zgjidhje duke e ndërruar pronën, apo lëvizjen e pronës pak më tutje, ndërrimin komplet të pronës ose kompensimin e sajë.

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr 28/2008); Nenit 24 dhe 25 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Nr.06-L-092; nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ; dhe pasi diskutoi për kërkesën e palës, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ZHVENDOSJEN E PRONËS KOMUNALE

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më: 29.09.2020, me shumicën e votave aprovoi Vendimin me të cilin aprovohet kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 e datës: 09.03.2020, të z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, për Zhvendosjen e Pronës së paluajtshme të Ngastrave Kadastrale me numër Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Zona Kadastrale – Davidovc, Kultura: Kullosë e klasës së -I- . Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, (10.248m²).

Duke e zhvendosur me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, me sipërfaqen e barabartë në pjesën e Ngastrës Kadastrale Nr.333/4; Zona Kadastrale – Davidovc; Kultura: Kullosë e klasës së -I- ; Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

II

A r s y e t i m: Zhvendosja e pronës së paluajtshme të Kuvendit të Komunës së Shtimes me pronën e personit fizik, z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, me sipërfaqen totale prej 10.248m², është bërë mbi bazën e nenit 24 dhe 25 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06-L-092 dhe nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për qëllimin e përmbushjes së interesit publik, për banorët e fshatit Davidovc. Zhvendosja është bërë edhe për arsye të mospajtimeve të gjata të shfrytëzimit të tokës në mes të pronarit të tokës z.Sali Beqaj me banorët e fshatit Davidovc. Pronari i tokës z.Sali Beqaj ka tentuar disa herë që të punoj në pronën e tij, por ishin banorët e lagjes së fshatit Davidovc të cilët e pengonin në mënyra të ndryshme ta shfrytëzojë pronën. Pronari i tokës z.Sali Beqaj por edhe banorët e lagjes së fshatit Davidovc kanë bërë disa kërkesa në adresë të Komunës dhe Kuvendit të Komunës së Shtimes, që t'i bëhet një zgjidhje të këtij rasti i cili ka

disa vite që qëndron si problem i pa zgjidhur në mes të dy palëve. Për këtë arsye, me qëllim të gjetjes së një zgjidhje të pranueshme për të dy palët, në zyrën e kryetarit të komunës u organizua takim me të dy palët. Më 7.7.2020 në ora 9:45 u organizua takim me z.Sali Beqaj dhe prej orës 11:15 me banorët e fshatit Davidovc të kryesuar nga kryetari i fshati z.Elmi Sadriu. Të dy palët u pajtuan për dy opsione, që të bëhet shpronësimi i pronës me mjete financiare apo zhvendosja e pronës. Për të dy takimet është mbajtur procesverbal dhe është nënshkruar nga pjesëmarrësit e takimit.

Mbi bazën e këtij takimi në të cilin edhe u arrit marrëveshje në mes të dy palëve, iu rekomandua Kuvendi të Komunës që të aprovohet njëra nga opsionet për të cilat janë pajtuar palët prezente në takim. Kuvendi i Komunës me shumicë të votave aprovoi opsionin e zhvendosjes së pronës së z.Sali Beqaj, ashtu siç është përshkruar në diapozitiv të këtij vendimi.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj